



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.11, datë 16.01.2023

PËR  
“TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës, nenin 46 pika 1 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe nenet 5, pika 5 dhe 6 pika 5 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Kledian Llaho, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
2. Zoti Kledian Llaho do të ushtrojë detyrën si Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, përkohësisht nga data 21.01.2023 – 20.07.2023.
3. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kledian Llaho, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

  
KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Eloida Coxhi

ANËTAR  
Mirela Bogdani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Arta Mandro

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Ledina Riza